



### FILLON ZBATIMIN PROGRAMI KOMBËTAR JASHTË ORARIT MËSIMOR

**Programi Jashtë Orarit Mësimor (JOM)**, një nga programet më të reja për fëmijët dhe të rinjtë, i cili nisi zbatimin në fund të janarit 2023 ka vijuar me zhvillimin e **kurseve tematike falas** gjatë këtij muaji në fushat: **pikturë; muzikë; kor; teatër; zeje; bujqësi dhe mjedis; sport dhe mirëqenie; dhe teknologji**. Programi JOM i ofron fëmijëve dhe të rinjve kohë mësimore shtesë dhe mundësi për zgjerim horizontesh, si dhe përvoja të shumëllojshme të të nxënësve, pa pagesë. Zbatimi i Programit JOM ka filluar në **200 shkolla në të gjithë Shqipërinë** duke i ofruar mundësi çdo fëmije dhe të riu të ndjekë kurse jashtëshkollore falas, 2 herë në javë jashtë orarit mësimor. Aktualisht ofrohen **1041 kurse tematike aktive**, të formuara nga grupe nxënësish prej 5-15 personash. Përgjatë muajit shkurt, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, ka zhvilluar një vizitë në shkollën 9-vjeçare "Ismail Qemali" në Shkodër, si dhe në shkollën "Jorgji Dilo" në Elbasan për të parë nga afër zbatimin dhe mbarëvajtjen e programit, ku edhe takoi nxënësit që ndjekin kurset e këtij programi.

Në datën 17 Shkurt, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, së bashku me Ministren e Arsimit dhe Sportit, morën pjesë në aktivitetet e organizuara nga mësuesit dhe fëmijët e **Programit JOM** në shkollën "Kosova", në kuadër të **15 vjetorit të pavarësisë së Kosovës**. Me nxënësit dhe mësuesit e shkollës, shijuan tingujt e këngëve patriotike dhe vallet tradicionale të përgatitura nga vogëlushët e korit, të cilët ndjekin pas shkolle kurset **falas të Programit Jashtë Orarit Mësimor**.



### PROGRAMI I KODIMIT

**Programi i Kodimit**, i cili u lancua në datën 23 janar, duke hapur kështu aplikimet për të gjithë të rinjtë, por jo vetëm, **numëron tashmë mbi 1900 aplikime**. Në qytetin e Elbasanit dhe të Shkodrës janë organizuar takime me të rinj, për të prezantuar kurset me mbështetje financiare nga qeveria dhe për të diskutuar rreth mundësive që ofron tregu i punës në fushën e teknologjisë së informacionit, duke filluar **nga pagat e larta, mundësia për të punuar online për kompani ndërkombëtare e shumë të tjera**.


Ndërkohë, në **qytetin e Tiranës dhe të Fierit, gjatë këtij muaji studentët e parë që kanë vendosur të ndryshojnë karrierë** apo të thellojnë njohuritë e tyre në fushën e programimit kanë filluar kurset pranë akademive të Albanian ICT Academy, Betaplan Coding Bootcamps, Holberton School dhe SDA by Protik. Me përfituesit e parë të kurseve me mbështetje financiare nga qeveria janë zhvilluar takime në ambientet e akademive përkatëse, për të diskutuar mbi procesin e aplikimeve dhe pritshmëritë nga këto kurse.

Aplikimet vazhdojnë të jenë të hapura dhe kryhen me anë të portalit e-Albania, në shërbimin **"Aplikim për kurset e zhvillimit profesional me mbështetje financiare nga qeveria"**.



### PREZANTIMI I PROGRAMIT TË KODIMIT PËR BIZNESET E SHOQATËS SË INVESTITORËVE TË HUAJ NË SHQIPËRI

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, së bashku me zëvendës ministren e Arsimit, Albana Tole, zhvilluan një bisedë të përbashkët me bizneset e Shoqatës së Investitorëve të Huaj në Shqipëri (FIAA), për të biseduar **rreth fushave të bashkëpunimit midis bizneseve dhe institucioneve me qëllim krijimin e më shumë mundësive për të rinjtë**. Gjatë diskutimit të problematikave të bizneseve, theksi u vendos tek burimet njerëzore në dy aspekte kryesore: ofrimi i kushteve më të mira për të rinjtë në vendin tonë dhe përgatitja e të rinjve me aftësitë e nevojshme për tregun teknologjik të punës. Në kuadër të mundësive të punësimit që do të ofrojë Programi i Kodimit, u diskutua me bizneset **bashkëpunimi për punësimin e të rinjve, si dhe ofrimin e bursave për të rinjtë që përfitojnë nga programi i kodimit**.



## MBAHET SESIONI INFORMUES PËR ERASMUS+ YOUTH NË BASHKËPUNIM ME ORGANIZATAT RINORE TË SHQIPËRISË DHE TË KOSOVËS

Në bashkëpunim me Zyrat Kombëtare Erasmus+ në Shqipëri dhe Kosovë, në 14 shkurt, u zhvillua një **takim informues për organizatat rinore të Shqipërisë dhe Kosovës** në kuadër të Thirrjes për projektet "Rritja e Kapaciteteve në fushën e Rinisë". Në takim morën pjesë mbi 50 organizata dhe ndër të tjera, u prezantua përgatitja e një **aplikimi të suksesshëm në Thirrjen e Programit Erasmus+ për projektet**, të cilat do të jenë të hapura për organizatat e shoqërisë civile në Shqipëri dhe Kosovë, me qëllim nxitjen e partneriteteve dhe aplikimeve të përbashkëta në thirrje. Takime të tilla nxisin **sinergji dhe bashkëpunime të mira sipas standarteve më të mira evropiane**, jo vetëm në hartimin dhe shkrimin e projekteve, por edhe në zbatimin e projekteve fituese.

## VAZHDOJNË STËRVITJET E EKIPEVE SPORTIVE

Në kuadër të **Programit Kombëtar të Ekipeve Sportive**, përgjatë muajit shkurt, janë zhvilluar një sërë takimesh me të rinjtë e ekipeve sportive në qytetin e Kuçovës, Elbasanit dhe Shkodrës, për të parë nga afër zbatimin e programit dhe për të takuar fëmijët dhe të rinjtë sportdashës të ekipeve të volejbollit dhe basketbollit. **Në muajin mars do të fillojë kampionati i ekipeve sportive, i cili përfundon në qershor.** Kampionati do të zhvillohet në fushën e volejbollit dhe basketbollit, me pjesëmarrjen e rreth **10000 të rinjve** pjesë e **700 skuadrave**.



## MBAHET AKTIVITETI "TIRANA CROSS COUNTRY"

Në datën 25, 26 Shkurt me organizimin e Federatës Shqiptare të Ciklizmit dhe mbështetjen nga Bashkia Tiranë, Ministria e Arsimit dhe Sportit, dhe Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, **u mbajt aktiviteti "Tirana Cross Country", me pjesëmarrjen e 200 nxënësve të 16 shkollave 9-vjeçare të qytetit të Tiranës**, me qëllim **promovimin e ciklizmit për një jetë të shëndetshme**. Të gjithë pjesëmarrësit pedatuan nga Bashkia Tiranë deri në afërsi të Kodrave të Liqenit Artificial, ku edhe filloi gara për djem dhe vajza në disiplinën Mountain Bike.



### TAKIM PËR INTERNETIN E SIGURT ME 54 KËSHILLAT VENDORË RINORË TË SHQIPËRISE

Me zhvillimin e teknologjisë, tashmë **94.4% e të rinjve kanë akses në internet** dhe bashkë me këtë vijnë edhe efektet anësore të saj.

Për të minimizuar të gjitha këto problematika, si dhe në kuadër të ditës ndërkombëtare të internetit të sigurt, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, ka ndërmarrë një nismë të re, për krijimin e një manuali për internetin e sigurt nga vetë të rinjtë. Në kuadër të kësaj nisme u zhvillua një takim online me mbi **100 përfaqësues nga 54 Këshilla Vendorë Rinorë**, ku u diskutua për problematikat që hasin fëmijët dhe të rinjtë në internet, si dhe **hapat për krijimin e manualit**.

Takimi online vazhdon me një fazë të dytë ku KVR-të e secilës bashki do të organizojnë takime të tjera me prindër, nxënës e mësues për qasjen e fëmijëve dhe të rinjve në internetin e sigurt.





### TRYEZA PËRMBYLLËSE E PROJEKTIT "AKTIVIZMI RINOR DHE DËGJIMI I ZËRIT TË TË RINJVE NË VENDIMMARRJEN LOKALE NË BASHKITË SKRAPAR DHE KUÇOVË" DHE TAKIMI ME KËSHILLAT VENDORË RINORË

Në datën 7 shkurt, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, mori pjesë në tryezën përfundimtare të projektit, i cili kishte në fokus **mundësitë që kanë të rinjtë për aktivitete, pjesëmarrje dhe vendim-marrje në bashkitë e vogla**. Në një tryezë të përbashkët, me aktorë të shoqërisë civile dhe përfaqësues të ndryshëm të bashkisë, **të rinjtë patën mundësinë të flisnin rreth sfidave që ata kanë në këto bashki**. Ndër të tjera, të rinjtë treguan me shumë pasion dhe dëshirë punimet e realizuara në kuadër të këtij projekti, si psh: kampi rinor, kurs pikturë, promovimi i vlerave të qyteteve si edhe një ekspozitë riciklimi. U zhvillua edhe **një takim me Këshillat Vendorë Rinorë të qyteteve të Kuçovës dhe Skraparit**, për të diskutuar mbi problematikat e të rinjve në bashkitë përkatëse dhe mënyrat për fuqizimin e aktivizimit e vazhdueshëm të tyre.



### NËSHKRUHET MARRËVESHJA E MIRËKUPTIMIT ME MALIN E ZI NË FUSHËN E RINISË

Në datë 27 shkurt, u mbajt mbledhja e dytë ndërqeveritare Shqipëri – Mali i Zi. Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, së bashku me kolegun e saj homolog, Vasilije Lalošević, Ministër i Sportit dhe Rinisë i Qeverisë së Malit të Zi, **nënshkruan memorandumin e bashkëpunimit në fushën e rinisë**. Me anë të memorandumit që nënshkruan, do të punohet **për të përmirësuar dhe rritur bashkëpunimin** në fushën e rinisë, konkretisht duke rritur shkëmbimet rinore, aktivizimin rinor, zhvillimin e trajnimeve të përbashkëta, shkëmbimin e eksperiencave, e shumë të tjera.



Link-u i aplikimit: [https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service\\_code=15126](https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=15126)